



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (QRK) - NR. 31/2024 PËR STANDARDET,
METODOLOGJINË DHE SISTEMIN E HARTIMIT DHE
MONITORIMIT TË PLANEVE OPERACIONALE PËR ZHVILLIM
RAJONAL TË RAJONEVE ZHVILLIMORE¹**

¹ Rregullore (QRK) Nr. 31/2024 për Standardet, Metodologjinë dhe Sistemin e Hartimit dhe Monitorimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal të Rajoneve Zhvillimore, është miratuar në mbledhjen e 223-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 09/223, të datës 09.10.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 19, paragrafi 1.3, të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, nenin 8, paragrafi 4, nënparagrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) - NR. 31/2024 PËR STANDARDET, METODOLOGJINË DHE SISTEMIN E HARTIMIT DHE MONITORIMIT TË PLANEVE OPERACIONALE PËR ZHVILLIM RAJONAL

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton standardet, metodologjinë dhe sistemin e hartimit dhe monitorimin e planeve operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore, konform dokumenteve të Ministrisë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe dokumenteve planifikuese dhe buxhetore të Qeverisë dhe Ministrisë përgjegjëse për financa si dhe buxhetit të miratuar.
2. Kjo rregullore është në përputhje me Rregulloret e BE-së 1299/2013, 1301/2013 dhe 1303/2013.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore është e zbatueshme për Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal, Qendrat për Zhvillim Rajonal, Institucionet e administratës shtetërore, komunat, organizatat joqeveritare, bizneset dhe partnerët kontribues në financimin e Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal.

Neni 3 Përkufizimet e termave dhe shkurtesave

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e përcaktuara me nenin 3 të Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

Neni 4 Parimet e Zhvillimit Rajonal të Balancuar

Gjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal zbatohen parimet e përcaktuara me Ligjin përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

KAPITULLI II

PËRGATITJA E PLANEVE OPERACIONALE PËR RAJONET ZHVILLIMORE

Neni 5

Planet Operacionale për Rajonet Zhvillimore

1. Planet Operacionale për Rajonet Zhvillimore (më tutje POZHR-të) janë dokumente bazë të planifikimit të cilat përcaktojnë objektivat dhe përparësitë e rajonit zhvillimor, me theks të veçantë nxitjen e zhvillimit të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale brenda rajonit zhvillimor, si dhe nxitjen e zhvillimit për zonat më pak të zhvilluara brenda rajonit zhvillimor.
2. Planet Operacionale për rajonet zhvillimore hartohen në përputhje me parimin e partneritetit dhe bashkëpunimit sipas procedurave dhe metodologjisë së përcaktuar me këtë rregullore, me kontributin e njësisive të vetëqeverisjes lokale të koordinuar nga qendrat për zhvillim rajonal në kuadër të një rajoni zhvillimor.
3. Planet Operacionale financohen nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe njëherësh duhet të jenë në përputhje me këtë Program dhe me këtë rregullore.
4. Bashkëfinancimi i planeve operacionale nga komunat dhe partnerët tjerë do të bëhet sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me rregulloret përkatëse për zbatimin e Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.
5. Planet Operacionale miratohen për një periudhë tre vjeçare (3) dhe mund të rishikohen sipas nevojës dhe arsyeshmërisë duke ndjekur metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 6

Struktura dhe përmbajtja e planeve operacionale për zhvillim rajonal për rajonet zhvillimore

1. Planet Operacionale për Rajonet Zhvillimore përmbajnë objektivat dhe prioritetet për zhvillimin e rajonit përkatës zhvillimor.
2. POZHR-të hartohen sipas formatit të bashkëngjitur në shtojcat e kësaj rregulloreje dhe përmbajnë:
 - 2.1. Prezantimin e pasqyres së përgjithshme për situatën dhe zhvillimin e rajonit zhvillimor përkatës;
 - 2.2. Identifikimin dhe vlerësimin e nivelit aktual të zhvillimit dhe nevojave zhvillimore për rajonin përkatës zhvillimor;
 - 2.3. Pjesën strategjike të Planit Operacional e cila përmban vizionin e zhvillimit për rajonin përkatës, objektivat e planit, treguesit dhe caqet për zhvillimin e rajonit zhvillimor përkatës. Qëllimi dhe objektivat e planit do të jenë në përputhje me Programin Zhvillimor Rajonal të Balancuar dhe i shërbejnë atij për rajonin zhvillimor përkatës;

2.4. Identifikimin e fushave prioritare për zhvillim për rajonin zhvillimor dhe të prioriteteve operacionale;

2.5. Masat sipas objektivave që shërbejnë për nxitjen e zhvillimit të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale brenda rajonit zhvillimor, si dhe nxitjen e zhvillimit për zonat më pak të zhvilluara brenda rajonit zhvillimor. Masat derivojnë nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar të cilat në POZHR zërthehen sipas nevojave dhe specifikave të rajonit përkatës;

2.6. Masat dhe buxhetin e nevojshëm për funksionimin e Qendrës përkatëse për Zhvillim rajonal.

2.7. Veprimet që lidhen me organizimin e planit, detajet procedurale dhe operative që do të ndërmarrin QZHR-të dhe palët e tjera përgjegjëse për realizimin e POZHR-së, si dhe afatet kohore dhe përgjegjësitë e zbatimit.

2.8. Idetë e projekteve prioritare dhe kandidatë për financim të propozuara nga komunat, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje dhe kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Rregulloren për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal. Plani përfshin ide të projekteve me të cilat komunat përkatëse do të aplikojnë sipas thirrjeve të shpallura nga Ministria përgjegjëse për zhvillim rajonal.

2.9. Buxhetin dhe burimet e financimit të POZHR-së përkatëse përfshirë edhe zotimet për bashkëfinancimin e projekteve nga komunat, bashkëfinancimin nga donatorë dhe burime të tjera të financimit.

2.10. Mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit operacional.

Neni 7

Kriteret për përfshirje të projekteve në POZHR

1. Për përfshirje në planin operacional, idetë e projekteve kandidatë të propozuara nga komunat duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:

1.1. Projekti duhet të kontribuojë në arritjen e objektivave dhe masave të POZHR-së.

1.2. Projekti nxit zhvillimin e balancuar në kuadër të rajonit zhvillimor dhe komunës për të cilën aplikon.

1.3. Në idetë e projekteve me të cilat aplikon komuna, duhet të dëshmohet se përfitojnë banorët e më shumë se një komune brenda rajonit të cilit i përket apo rajonit tjetër.

1.4. Projekti me të cilin aplikon komuna duhet të jetë projekt i ri dhe jo vazhdimësi e ndonjë projekti tjetër (me përjashtim të rasteve kur projekti bartet nga viti paraparak i financuar nga MZHR);

1.5. Komunat përfituese duhet të ofrojnë zotimin për bashkëfinancim të shumës minimale siç përcaktohet me PZHRB.

1.6. Komunat përfituese duhet të kenë të nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit ndërkomunal për themelimin e Qendrës për Zhvillim Rajonal në kuadër të rajonit të cilit i përkasin.

Neni 8

Koordinimi i përgjithshëm i hartimit të planeve operacionale

1. Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal koordinon procesin e përgjithshëm të hartimit të POZHR-ve me qëllim të sigurimit që ato të hartohen me kohë dhe sipas standardeve të përcaktuara me këtë rregullore. Ndërkaq, QZHR-të koordinojnë procesin e hartimit të planeve individuale për rajonin të cilit i përkasin.
2. Pas miratimit të PZHRB-së ministria miraton një kalendar për hartimin e planeve operacionale për secilin rajon zhvillimor.
3. Kalendarin për hartimin e planeve operacionale hartohet në pajtim me PZHRB-në.
4. Kalendarin përfshin planet operacionale që do të hartohen për periudhën të cilën e mbulon PZHRB-ja, afatet për fillimin e hartimit, finalizimin e planeve që hartohen si dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse për hartimin e tyre.
5. POZHR-të duhet të finalizohen dhe miratohen brenda afatit të përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal pas miratimit të PZHRB-së.

Neni 9

Strukturat koordinuese për Planet Operacionale për Zhvillim Rajonal

1. Në secilin rajon zhvillimor themelohet Grupi koordinues për POZHR.
2. Grupet Koordinuese janë përgjegjëse për përgatitjen e planeve, si dhe koordinimin e procesit të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të POZHR-ve përkatëse.
3. Grupet koordinuese për POZHR udhëhiqen nga Udhëheqësi/-ja e Qendrës përkatëse për Zhvillim Rajonal dhe do të përbëhen nga:
 - 3.1. Një përfaqësues i secilës komunë në kuadër të rajonit zhvillimor përkatës.
 - 3.2. Përfaqësues të palëve tjera të interesuara dhe ekspertë të jashtëm.
4. Qendrat për zhvillim Rajonal do të ofrojnë mbështetjen profesionale, teknike dhe organizative për grupet koordinuese për POZHR-të përkatëse.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të grupit koordinues për POZHR dhe emrat e anëtarëve të grupeve koordinuese përcaktohen me vendimin për themelimin e tyre nga ana e udhëheqësit të Qendrës përkatëse Rajonale Zhvillimore.

6. Anëtarët e grupeve koordinuese nga komunat emërtohen sipas vendimit të kryetarëve të Komunave të rajonit përkatës. Përfaqësuesit e palëve të tjera dhe ekspertët e jashtëm përcaktohen nga udhëheqësit e Qendrës përkatëse Rajonale Zhvillimore.

Neni 10

Përgatitja e planeve operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore

1. Përgjegjësinë e hartimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal të rajoneve përkatëse zhvillimore e kanë Qendrat për Zhvillim Rajonal në bashkëpunim me komunat e rajonit përkatës.

2. Përgatitja e planeve operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore bëhet nga grupet koordinuese për POZHR.

3. Në pajtim me kalendarin e miratuar nga Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal, grupi koordinues miraton një plan të detajuar të punës për procesin e hartimit të POZHR. Plani do të përcaktojë rolet e anëtarëve të ekipit hartues, fushat e të dhënave dhe informatave që do të mbledhen dhe analizohen, hapat që duhet të ndiqen, afatet kohore për hartim dhe burimet e nevojshme.

4. Në pajtim me kornizën e financimit të përcaktuar me Programin Zhvillimor Rajonal dhe mundësitë e financimit përmes bashkëfinancimeve, anëtarët e grupit koordinues do të ofrojnë propozimet e tyre për planin përkatës operacional përmes masave dhe ideve të projekteve konkrete për t'u përfshirë në planin përkatës operacional për zhvillim rajonal.

5. Projektet do të propozohen në formën e koncept projekteve/ideve të projekteve sipas formatit të përcaktuar me shtojcën 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Shqyrtimi dhe miratimi i Planeve Operacionale për Rajonet Zhvillimore

1. Pas finalizimit të POZHR-së, Qendra përkatëse për Zhvillim Rajonal e përcjell propozimin e planit operacional tek Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal për shqyrtim dhe miratim.

2. Ministria, gjegjësisht departamenti përgjegjës për zhvillim rajonal në afat prej 15 ditësh të punës nga dita e pranimit të projektit të POZHRB-së, jep opinionin e saj me shkrim nëse dokumenti mund të miratohet nga Ministri përgjegjës për zhvillim rajonal apo dokumenti do të kthehet për plotësim sipas rekomandimeve të ofruara.

3. Ministria, gjegjësisht departamenti përgjegjës për zhvillim rajonal siguron që planet operacionale i shërbejnë arritjes së objektivave të POZHRB-së, si dhe janë në përputhje me kornizën strategjike dhe planifikuese të tyre.

4. Ministria, gjegjësisht departamenti pëgjegjës për zhvillim rajonal siguron që masat dhe projektet që planifikohen të financohen përmes POZHR-së janë në pajtim me mundësitë dhe kornizën buxhetore të përcaktuar me PZHRB për rajonin zhvillimor përkatës dhe mundësitë për bashkë-financimin e tyre.

5. Në rast se Ministria, gjegjësisht departamenti pëgjegjës për zhvillim rajonal konstaton se POZHR-ja nuk i përmbush kriteret sipas kësaj rregulloreje, propozimi i planit operacional i kthehet Qendrës përkatëse për Zhvillim Rajonal për plotësim sipas rekomandimeve konkrete të ofruara nga Ministria.

6. QZHR-ja propozuese së bashku me grupin koordinues përkatës duhet të plotësojnë POZHR-në sipas rekomandimeve të ministrisë.

7. Pas plotësimit dhe ndryshimit, propozimi i POZHR-së i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal për shqyrtim final dhe miratim.

KAPITULLI III

FINANCIMI I PLANEVE OPERACIONALE PËR ZHVILLIM RAJONAL

Neni 12

Fushat e financimit përmes planeve operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore

1. Fushat e financimit të POZHR-së përcaktohen sipas Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.
2. POZHR-të shërbejnë për të identifikuar dhe përzgjedhur fushat dhe projektet prioritare për financim që adresojnë nevojat zhvillimore të rajonit zhvillimor përkatës.
3. Ministria, bazuar në vlerësime paraprake, përmes udhëzuesit për thirrje publike për aplikim përcakton specifika të veçanta për financim.

Neni 13

Përfituesit e planeve operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore

1. Përfituesit e mundshëm të POZHR-ve, sipas Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe kësaj rregulloreje, janë:
 - 1.1. Komunat si dhe institucionet tjera në nivel të komunës në kuadër të rajonit zhvillimor përkatës;
 - 1.2. Qendrat për Zhvillim Rajonal të rajonit zhvillimor që mbulon;
 - 1.3. Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore të rajonit përkatës zhvillimor;

1.4. Organizatat e Shoqërisë Civile të rajonit përkatës zhvillimor;

1.5. Bizneset e rajonit përkatës zhvillimor.

Neni 14 **Kushtet dhe kriteret e financimit**

1. Kushtet dhe kriteret për aplikim, përzgjedhja e projekteve dhe financimi i POZHR-ve janë të përcaktuara me Rregulloren për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

2. Udhëzuesit për aplikim do të specifikojnë kushtet sipas thirrjes për propozime, shumat, përqindjet minimale dhe maksimale të kostove, si dhe trajtimin e kontributeve në natyrë.

Neni 15 **Burimet e financimit**

1. Burimet e financimit të zhvillimit rajonal të balancuar në Republikën e Kosovës janë:

1.1. Buxheti i planifikuar përmes ministrisë përgjegjëse për zhvillim Rajonal;

1.2. Buxhetet e komunave për projektet për të cilat komunat japin kontributet e bashkëfinancimit;

1.3. Fondet e Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë.

2. Pavarësisht kostos së përgjithshme të zbatimit të POZHB-së për periudhën tri vjeqare, shumat e mjeteve për financimin e planeve operationale ndahen sipas metodologjisë së ndarjes së mjeteve për rajonet zhvillimore të përcaktuara me Rregulloren për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

3. Buxheti alokohet në funksion të zbatimit të POZHR-së në përputhje me parashikimet e buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm dhe menaxhohet nga Ministria.

Neni 16 **Ndarja e mbështetjes financiare**

1. Mbështetja financiare për rajonin zhvillimor ndahet sipas masave për kategoritë e përfituesve të POZHR-së.

2. Ndarja e mbështetjes financiare për QZHR-të bëhet përmes POZHR-ve dhe sipas Rregullores për themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e Qendrave për zhvillim rajonal në rajonet zhvillimore.

3. Përzgjedhja e projektideve që përfshihen në POZHR si dhe projekteve që përzgjedhen për financim do të reflektojë nivelin e zhvillimit rajonal sipas shkallës së bruto produktit vendor,

numrit të banorëve të komunës përkatëse, dhe synon nxitjen e zhvillimit të balancuar ndërmjet komunave dhe ndërmjet zonave urbane dhe rurale në komuna.

4. Mbështetja financiare për projektet kapitale për komuna bëhet për idetë e projekteve të cilat propozohen nga komunat dhe përfshihen në POZHR.

5. Përzgjedhja e ideve të projekteve për t'u përfshirë në POZHR bëhet nga grupi koordinues sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me nenin 7 të kësaj rregulloreje.

6. Përzgjedhja e projekteve për financim bëhet përmes procedurave konkurruese që zhvillohen, pas aplikimit nga komunat me projektet nga lista e projektideve që janë përfshirë në POZHR pas miratimit dhe sipas dinamikës së zbatimit të tij.

7. Procedura e përzgjedhjes për përfituesit sipas paragrafit 1.3 deri 1.5 të nenit 13 të kësaj rregulloreje bëhet pas hapjes së thirrjeve të hapura për këta përfitues sipas masave të cilat përfshihen në POZHR.

8. QZHR-të përkatëse do të ndihmojnë komunat për identifikimin dhe përgatitjen e projektideve për përfshirje në POZHR.

Neni 17

Procedurat e përgjithshme për zbatimin e POZHR-ve

1. Procedurat e ndarjes së mbështetjes financiare për projektet e propozuara në POZHR zhvillohen mbi bazën e thirrjeve publike.

2. Buxheti i paraparë për mbështetje financiare, fushat e mbështetjes financiare, dokumentet e nevojshme për aplikim, udhëzimet për aplikim dhe informata të tjera me rëndësi publikohen përmes thirrjes publike.

3. Thirrja publike për secilën mbështetje financiare duhet të publikohet në ueb faqen e Ministrisë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal. Thirrja publike mund të publikohet edhe përmes mjeteve të tjera.

4. Në thirrjen publike përcaktohen saktë kriteret e veçanta për pjesëmarrje, mënyra e aplikimit dhe procedurat që duhen zbatuar gjatë aplikimit për mbështetje financiare.

KAPITULLI IV MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANEVE OPERACIONALE

Neni 18

Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal

1. Ministria, përkatësisht Departamenti përkatës për Zhvillim Rajonal, është përgjegjës për monitorimin e përgjithshëm të zbatimit të POZHR-ve përmes QZHR-ve.
2. Koordinimi i monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të POZHR-ve bëhet nga grupet koordinuese për POZHR-të.
3. QZHR-të janë përgjegjëse për koordinimin e procesit të mbledhjes së informatave dhe hartimin e raporteve periodike për zbatimin e POZHR-ve.
4. Pas diskutimit dhe miratimit në grupet koordinuese për POZHR-të, raportet për monitorimin e zbatimit të POZHR-të dërgohen në Minsitrinë përgjegjëse për zhvillim rajonal.
5. QZHR-të përkatëse obligohen që të raportojnë në Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal përmes raportit gjastëmujor (më së largu një muaj pas përfundimit të periudhës së raportimit) ndërsa raportet vjetore dërgohen në ministri më së largu deri më 31 mars të vitit pasues.
6. Raportet për monitorimin e zbatimit të POZHR-ve shërbejnë për monitorimin dhe raportimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe arritjen e objektivave të tij.

Neni 19

Vlerësimi i Planeve Operacionale për Zhvillim Rajonal

1. Qendrat për Zhvillim Rajonal menaxhojnë procesin e vlerësimit të POZHR-ve.
2. Vlerësimi i POZHR-ve do të bëhet për periudhën tre vjeqare të cilën e mbulon Plani Operacional për Rajonet Zhvillimore.
3. Vlerësimi i POZHR-ve do të bëhet sipas kriterëve dhe metodologjisë së vlerësimit të përcaktuar me Rregulloren përkatëse për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe PZHRB-së.
4. Raportet e vlerësimit të POZHR-ve i dërgohen Ministrisë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe shërbejnë si bazë kryesore për vlerësimin e arritjes së objektivave të PZHRB-së dhe identifikimin e nevojave për mbështjetjen financiare për rajonet zhvillimore.

KAPITULLI V
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E PLANEVE OPERACIONALE
PËR ZHVILLIM TË BALANCUAR

Neni 20
Ministria e Zhvillimit Rajonal

1. Përgjegjësitë e Ministrisë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal për POZHR-të janë si në vijim:
 - 1.1. Mbikqyr dhe bën koordinimin e përgjithshëm të hartimit të POZHR-ve;
 - 1.2. Shqyrton dhe miraton Planet Operacionale për Zhvillim Rajonal;
 - 1.3. Gjatë shqyrtimit të POZHR-ve, Ministria siguron që planet operacionale i shërbejnë arritjes së objektivave të Strategjisë për Zhvillim rajonal të Balancuar dhe Objektivave të PZHRB-së, si dhe janë në përputhje me kornizën strategjike dhe planifikuese të tyre;
 - 1.4. Ministria, kujdeset që ndarja e mbështetjes financiare të bëhet në mënyrë proporcionale me nevojat e komunave në një rajon zhvillimor;
 - 1.5. Shqyrton raportet periodike për implementimin, monitorimin dhe menaxhimin e POZHR-ve;
 - 1.6. Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave të projekteve të financuara nga POZHR-të dhe harton raporte periodike në nivel të vendit;
 - 1.7. Mbështetë komunat në zhvillimin e kapaciteteve për përgatitjen e projekteve që mbështeten nga POZHR, menaxhimin e tyre në kuadër të rajoneve zhvillimore dhe akterët e tjerë të zhvillimit;
 - 1.8. Në pajtim me Ligjin përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar, vendos për përfituesit e projekteve të zhvillimit rajonal sipas Programit për Zhvillim Rajonal të balancuar dhe POZHR-ve.

Neni 21
Komunat

1. Përgjegjësitë e komunave për POZHR-të janë si në vijim:
 - 1.1. Marrin pjesë aktive në sktrukturat koordinuese përkatëse për identifikimin e nevojave të tyre, hartimin dhe monitorimin e POZHR-ve;
 - 1.2. Ofrojnë propozime për masa dhe ide të projekteve për t'u përfshirë në POZHR-në përkatëse;
 - 1.3. Sigurojnë bashkëfinancimin e nevojshëm për projektet për të cilat aplikojnë në kuadër të

POZHR-ve;

1.4. Kontribuojnë në nxitjen e zhvillimit të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale brenda komunës dhe rajonit zhvillimor, si dhe nxitjen e zhvillimit për zonat më pak të zhvilluara brenda komunave;

1.5. Kontribuojnë që përmes projekteve të përbashkëta të nxisin bashkëpunimin ndërkomunal për të zvogluar dallimet zhvillimore mes komunave;

1.6. Ofrojnë bashkëpunimin e nevojshëm për përgatitjen, monitorimin dhe raportimin e POZHR-ve;

1.7. Bashkëpunojnë me QZHR-në për të mundësuar zbatimin e POZHR-së në rajonet të cilave ju përkasin;

1.8. Ofrojnë të dhënat e kërkuara nga QZHR-të përkatëse për llogaritjen e treguesve të përcaktuar për matjen e indeksit për zhvillim rajonal të balancuar;

1.9. Angazhohen me institucionet e tjera dhe partnerët e tjerë për sigurimin e bashkëpunimit në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të projekteve të POZHR-ve.

Neni 22 **Qendrat për Zhvillim Rajonal**

1. Përgjegjësitë e QZHR-ve për POZHR-të janë si në vijim:

1.1. Udhëheqin grupet koordinuese përkatëse për POZHR-të;

1.2. Udhëheqin procesin e hartimit të POZHR-ve në përputhje me nenin 8 të ligjit Nr. 08/L-190 për zhvillim Rajonal të balancuar;

1.3. Përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve dhe ofrojnë mbështetje për njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe institucionet e tjera që veprojnë në rajonet përkatëse zhvillimore në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim realizimin e POZHR-ve në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal në rajonet zhvillimore;

1.4. Mbështesin komunat, OJQ-të dhe bizneset në kuadër të rajoneve të cilave ju përkasin në hartimin e projekteve dhe për aplikim në mbështetjen që ofron POZHR-ja;

1.5. Grumbullojnë të dhëna statistikore dhe informata tjera relevante për rajonet përkatëse zhvillimore të cilat janë të nevojshme për matjen e ndryshimeve tek indikatorët socio-ekonomik të ndërlidhur me zhvillimin rajonal të balancuar të cilat shfrytëzohen për proceset e raportimit dhe të planifikimit;

1.6. Detyra tjera që parashihen në Rregullorën përkatëse për themelimin e QZHR-së e që lidhen me POZHR-të.

KAPITULLI VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23 Zbatimi

1. Për zbatimin e Rregullores për Planet Operacionale për Zhvillim Rajonal dhe Rregullores përkatëse për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ministria do të përgatitë udhëzues për secilën thirrje veç e veç.
2. Dispozitat aktuale të mbështetjes për projektet të cilat janë në realizim e sipër do të zbatohen deri në miratimin e Programit dhe POZHR-ve për zhvillim rajonal të balancuar, si dhe hyrjes në fuqi të rregullores për QZHR-të.

Neni 24 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës
29 tetor 2024

SHTOJCA 1. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PLANIT OPERACIONAL PËR ZHVILLIM RAJONAL

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky seksion përmban një përmbledhje të situatës aktuale dhe nevojave të rajonit zhvillimor si dhe objektivat, masat, dhe veprimet që do të ndërmerren për zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve që mundësojnë zhvillimin e balancuar brenda rajonit zhvillimor.

2. Hyrje

Ky seksion përshkruan arsyen e hartimit të POZHR-së, ndërlidhjen e saj me PZHRB-në dhe Strategjinë për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

3. Metodologjia

Ky seksion përfshin një përshkrim të shkurtër të qasjes ose metodologjisë së përdorur dhe procesin për hartimin e dokumentit strategjik, përfshirë komunat dhe palët tjera të konsultuara, procesin e konsultimit dhe finalizimit të planit operacional.

4. Analiza e situatës (apo Sfondi)

Prezantimi i një pasqyreje të përgjithshme për situatën dhe zhvillimin e rajonit zhvillimor përkatës si dhe identifikimi, vlerësimi dhe analiza e gjendjes së zhvillimit dhe nevojave zhvillimore për rajonin përkatës zhvillimor.

Kjo pjesë do të përfshijë informata të përgjithshme për karakteristikat e rajonit zhvillimor, përfshirë informatat e zhvillimeve demografike, ekonomike, gjeografike etj.

Në këtë pjesë ofrohen informata sipas sektorëve apo fushave zhvillimore duke identifikuar nevojat e rajoneve të cilat mundësojnë identifikimin e fushave prioritare. Mund të përdoren mjete të ndryshme të analizës, si analiza SWOT, analiza e pemës së problemit, etj.

Mund të përdoren grafikë dhe imazhe për të mbështetur analizën dhe informatat e dhëna ose referencat përkatëse.

5. Pjesa strategjike

5.1. Pjesa strategjike e Planit Operacional e cila përmban vizionin dhe perspektivën e zhvillimit për rajonin përkatës, qëllimin e planit, objektivat, treguesit dhe caqet për zhvillimin e rajonit zhvillimor përkatës e të cilat mund të arrihen përmes masave dhe projekteve të dedikuara për komunat dhe përfituesit e tjerë në kuadër të rajoneve zhvillimore. Qëllimi dhe objektivat e planit do të jenë në përputhje me Programin Zhvillimor Rajonal të Balancuar dhe i shërbejnë atij për rajonin zhvillimor përkatës. Objektivat dhe caqet që synohet të arrihen brenda periudhës së zbatimit duhet të bazohen në mundësitë dhe buxhetin e ndarë për zbatimin e planit përkatës operacional.

5.2. Fushat prioritare: Identifikimi i fushave prioritare për zhvillim për rajonin zhvillimor dhe prioritetet operationale.

5.3. Masat që zbatohen sipas objektivave që shërbejnë për nxitjen e zhvillimit të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale brenda rajonit zhvillimor, si dhe për nxitjen e zhvillimit për zonat më pak të zhvilluara brenda rajonit zhvillimor. Këtu zbërthehen në nivel konkret masat përkatëse të PZHRB-së sipas nevojave të rajonit zhvillimor.

6. Ndikimi buxhetor i zbatimit të POZHB-së

Bëhet vlerësimi i kostos për secilin aktivitet, masë dhe projekt të propozuar sipas objektivave si dhe i kostos totale për zbatimin e POZHR-së.

Duhet gjithashtu të ofrohen informata të detajuara për burimet e financimit duke përfshirë referencat për buxhetin e ndarë nga PZHRB-ja, shumat e zotuarat për projektet e bashkëfinancimit nga komunat, donatorët apo burime të tjera të financimit.

7. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi

Ofrohen informata për mekanizmat e monitorimit, frekuencën e raportimit dhe nivelin informatave që raportet e monitorimit duhet të përmbajnë si dhe vlerësimin e zbatimit të planit operacional.

8. Pjesa Operacionale

Paralelisht me procesin e hartimit të pjesës strategjike të dokumentit, duhet të hartohet edhe pjesa operacionale e POZHR-së e cila është pjesë përbërëse e planit.

Plani i veprimit duhet të specifikojë aktivitetet, masat dhe projektet e nevojshme për arritjen e objektivave të POZHR-së.

Plani i veprimit përbëhet nga tri pjesë:

1. Plani i veprimeve menaxheriale, procedurale dhe operacionale

Plani i veprimit përfshin veprimet e zbatimit, afatet kohore, dhe përgjegjësitë e zbatimit siç paraqiten në pjesën e parë të shtojcës nr. 2. Veprimet do të përfshijnë ato të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e planit, aspektet procedurale dhe operative të cilat QZHR-të dhe palët tjera përgjegjëse do të ndërmarrin për zbatimin e POZHR-së.

2. Plani i për zbatim

Plani i zbatimit përmban objektivat, treguesit, masat dhe idetë e projekteve (idetë e projekteve kandidate të cilat përfshihen vetëm për masat për shpenzimet kapitale për komuna) të cilat kanë për qëllim adresimin e nevojave të identifikuarat për rajonin zhvillimor, gjithmonë brenda kornizës së përcaktuar me Programin për Zhvillimin Rajonal të Balancuar. Elementet që duhet të përmbajë plani në pjesën e projekteve të propozuara janë renditur më poshtë:

2.1. Objektivat, identike siç janë përcaktuar në tekstin e pjesës strategjike, përfshirë edhe indikatorët dhe caqet.

2.2. Masat, gjithashtu për secilin objektiv, të cilat janë identike me ato të pjesës strategjike.

2.3. Masat të cilat derivojnë nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar të cilat zërthehen për nevojat e rajonit përkatës ndahen sipas përfituesve. Për shembull, masat për komunat që konsisojnë në masa për shpenzime kapitale, masa për biznese, e kështu më radhë.

2.4. Për secilën masë vendoset:

- a. Afati apo koha e zbatimit të masës;
- b. Shuma e mjeteve financiare të ndara për masën përkatëse;
- c. Shuma e mjeteve financiare për masën e ndarë nga mjetet e MZHR-së përmes PZHRB-së;
- d. Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime tjera, bashkëfinancime, donatorë, etj.;
- e. Kush përfiton nga masa e zbatuar;
- f. Rezultatet që syhohen të arrihen nga zbatimi i masës.

3. Për masat e shpenzimeve kapitale, për të cilat komunat duhet të propozojnë idetë e projekteve në plan, ofrohen këto informata:

- a. Idetë e projekteve të propozuara dhe kandidatët për financim;
- b. Afati i zbatimit për çdo projekt, përfshirë kohëzgjatjen e projektit, nëse ai projekt kalon fazën tjetër të përzgjedhjes;
- c. Komuna përgjegjëse apo institucioni tjetër komunal që ka propozuar idenë e projektit dhe synon ta fitojë atë projekt;
- d. Kostoja e vlerësuar e zbatimit;
- e. Kostoja që kërkohet nga PZHRB-ja;
- f. Kontributi i bashkëfinancimit;
- g. Përfituesit e projektit përfshirë kategoritë e popullatës që do të përfitojnë, numrin e përafërt të banorëve që mund të përfirojnë;
- h. Rezultatet e pritshme të projektit.

4. Lista e ideve të projekteve me informatat sipas formularit në shtojcën nr. 3 si më poshtë.

Plani gjithashtu duhet të mbulojë një periudhë zbatimi 3-vjeçare, me mundësi të rishikimit vjetor.

Kostoja totale e zbatimit të POZHR-së për periudhën e saj 3-vjeçare dhe ndarja e kostove sipas objektivave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit.

Shtojca e projektpropozimeve, me informata për idenë e projektit, koston dhe informata të tjera të nevojshme sipas formularit të ofruar.

Shtojca 2. Modeli i planit rajonal të balancuar

PLANI PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR 2025-2027
RAJONI ZHVILLIMOR:

Plani për veprimet procedurale dhe operative

Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës
Veprimi 1.		
Veprimi 2.		
Veprimi 3.		

Plani i zbatimit për periudhën trevjegjare

Objektivi	Baza	Caku i ndërmjetëm	Caku final	Rezultati i pritshëm			
Objektivi 1.							
Treguesi 1.							
Treguesi 2.							
Masa: Investimet Kapitale			Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën, e ndarë nga mjetet e MZHR-së	Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime të tjera, bashkëfinancime, donatorë, etj.	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës
1.							
2							
Ideja e projektit (vetëm për projekte kapitale për komuna)	Koha e zbatimit përfshirë kohëzgjatjen e	Kostoja Totale	Kostoja që kërkohet nga PZHRB-	Kontributi i bashkëfinancimit	Komuna/institucioni përgjegjës	Përfituesit e projektit	Rezultati i pritshëm në nivel të projektit

	projektit		ja			
1.						
2.						
Masa: Mbështetje për bizneset		Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën, e ndarë nga mjetet e MZHR-së	Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime të tjera, bashkëfinancime, donatorë, etj.	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës
1.						
2.						
Masa: Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile		Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën	Burimi i financimit	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës
1.						
2.						
Masa: Mbështetje për Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore të rajonit përkatës zhvillimor		Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën, e ndarë nga mjetet e MZHR-së	Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime të tjera, bashkëfina	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës

					ncime, donatorë, etj.			
1								
2								
Objektivi	Baza	Caku i ndërmjetëm	Caku final	Rezultati i pritshëm				
Objektivi 2.								
Treguesi 1.								
Treguesi 2.								
Masa: Investimet Kapitale				Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën, e ndarë nga mjetet e MZHR-së	Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime të tjera, bashkëfinancime, donatorë, etj.	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës
1.								
2								
Ideja e projektit (vetëm për projekte kapitale për komuna)	Koha e zbatimit përfshirë kohëzgjatjen e projektit	Kostoja Totale	Kostoja që kërkohet nga PZHRB-ja	Kontributi i bashkëfinancimit	Komuna/institucioni përgjegjës	Përfituesit e projektit	Rezultati i pritshëm në nivel të projektit	

Masa: Mbështetje për bizneset	Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën, e ndarë nga mjetet e MZHR-së	Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime të tjera, bashkëfinancime, donatorë, etj.	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës	
1						
2						
Masa: Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile	Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën, e ndarë nga mjetet e MZHR-së	Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime të tjera, bashkëfinancime, donatorë, etj.	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës	
1						
2						
Masa: Mbështetje për Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore të rajonit përkatës zhvillimor	Koha e zbatimit të masës	Shuma e mjeteve financiare për masën, e ndarë nga mjetet e	Shuma e ndarjes së mjeteve nga burime të tjera,	Përfituesit e masës	Rezultati i pritshëm në nivel të masës	

		MZHR-së	bashkëfina ncime, donatorë, etj.		
1					
2					

Shtojca 3. Formulari për ide për projektet kapitale për komuna

[kërkohet të ofrohen informata të mjaftueshme, të qarta dhe koncize për secilën kategori]

1. Emri/titulli i Projektit	
2. Propozuesi i projektit	
3. Koha e zbatimit përfshirë kohëzgjatjen e projektit	
4. Buxheti total i projektit	
5. Përqindja e kontributit në rast të bashkëfinancimit të projektit	
6. Bartësi i bashkëfinancimit	
7. Fusha të cilës i përket projekti	
8. Prioriteti i POZHB-së të cilit i kontribuon projekti	
9. Objektivi/-at e POZHB-së me të cilat ndërlidhet projekti	
10. Masa/-t e POZHB-së me të cilat ndërlidhet projekti	
11. Përshkrimi i projektit	
12. Grupet e synuara dhe përfituesit e projektit	
13. Objektivat e projektit	
14. Rezultatet e pritshme të projektit	
15. Aktivitetet e projektit	
16. Përfituesit e projektit	